



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:226062

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05678147

**C.nr.3316/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestuese të inicuar me padi nga ana e paditësit N.K. me vendbanim në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqësojnë av. B.K. dhe av. F.G. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 13. 05.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit N.K. me vendbanim në fshatin ..... Komuna e Prizrenit dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të shujtave ditore për **193 ditë** pune gjatë periudhës kohore nga data 01.01.2022 deri më 15.11.2022, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **386.00 (treqind e tetëdhjetë e gjashtë) euro**, me kamatë ligjore prej 8%, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**II. DETYROHET** e paditura, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 (njëqind e njëzetë e katër) euro**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësi N.K. me vendbanim në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarëve të tij av. B.K. dhe av. F.G. që të dy nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 24.10.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtave ditore.

Në referatin e padisë të autorizuarit e paditësit kanë theksuar se paditësi/mësimdhënësit i takon kompensimi për shujtat për vitin 2022 nga dy (2) euro në ditë për çdo ditë pune, ashtu siç

parashihet me nenin 35 para.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ku edhe pse kanë bërë kërkesa të vazhdueshme për pagesën e këtyre shujtave pranë DKA-së dhe deri më tani nuk kanë marrë përgjigje. Meqenëse komuna nuk e ka përmbushur vullnetarisht kërkesën e paditësit, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpapia e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka se theksuar në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/488 të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar. Më tej ka theksuar se paditësi nuk ka ofruar prova që është anëtarë i sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t'ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veproj në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Po ashtu ka theksuar se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënës dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në SH.F.M.U. “Bajram Curri” në fshatin Romajë, Komuna e Prizrenit, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes vërtetimit me numër të referencës 89/23, të datës 14.02.2023, të lëshuar nga ana e të paditurës, ka vërtetuar faktin se paditësi N.K. nga data 01.01.2022 deri më 15.11.2022, ka punuar 193 ditë pune.

Nga leximi i kërkesës e datës 12.11.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi dhe të tjerët i janë drejtuar Komunës së Prizrenit-Drejtorisë Komunale të Arsimit për kompensimin e shujtave ditore dhe e njëjta nuk i është përgjigjur kërkesës së paditësit.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimin e lëshuar nga ana e SH.F.M.U. “Bajram Curri”, në fshatin Romajë, Komuna e Prizrenit, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e prezencës në punë të paditësit, gjykata ia fali besimin e plotë, e nga e cila vërtetoi faktin se për 193 ditë nga data 01.01.2022 deri me datën 15.11.2022, paditësi ka qenë në vendin punës.

Me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese, të të punësuarve për ushqim”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si mësimdhënës t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditësin, të vërtetuara nga vet punëdhënësi, për 193 ditë prezent në punë, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 2 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadija e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të

paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumën prej 20.00 euro, gjithsej shumën prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

2023:226062, 13.05.2024

**B.profesional**  
**Ali Kosova**

**Gjyqtari**  
**Agron Karatash**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.